



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7767
Data: 13.09.2023

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME OJQ-të DHE SHOQATAT PËR
DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2025-2026**

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026, të mbajtur me datën **15.08.2023**, duke filluar nga ora **11:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 20 pjesëmarrës, prej tyre 8 gra dhe 12 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2024, si dhe parashikimi për vitet 2025-2026, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Ne kemi pranuar Qarkoren e parë Buxhetore, kemi dhënë disa propozime dhe kemi hartuar një draft buxhet mbi planifikimin buxhetor për vitin 2024, si dhe vlerësimet e para për vitet 2025-2026. Jemi në fazën e dëgjimeve buxhetore publike për projektet që ne i kemi paraqitur, për t'i parë edhe ju se çka kemi në projeksionet buxhetore tona për këto vite dhe t'i marrim idetë dhe propozimet tuaja sipas kërkesave dhe nevojave tuaja që i kemi, ku risi këtë vit është se kemi organizu dëgjim buxhetor të dedikuar për OJQ-të dhe shoqatat për të realizuar një plan buxhetor, i cili do të kalojë disa faza. Ne kemi bashkëpunu me të gjitha drejtoritë që kemi, kemi bërë disa propozime. Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke

filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur diskutime me asamblenë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2024 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,583,941.00 €), granti specifik për arsim (1,089,623.00€), granti specifik për shëndetësi (401,388.00€) dhe të hyrat vetanake komunale (274.736.00 €). Pra, buxheti total për vitin 2024 do të jetë 3,349,278.00 €. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore, përveç tek të hyrat vetanake komunale ku do të ketë rënie prej 51%. Mandej vijnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

1 Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit.

Muhamed Suma: Sot përfaqësoj OJQ “Mjalti” dhe në konsultim me shokët nga OJQ kemi listu disa pika. Fillimisht kemi evidentu një çështje që të hyrat vetanake për vitin 2024 parashikohen të jenë në lartësi prej 274 mijë €, pra më pak se viti paraprak prej 51% dhe sipas mundësisë një sqarim se me çka ka të bëjë kjo, si dhe të çështja e tatimit në pronë me vendimin e marrë nga qeveria për faljen e tatimit në pronë. Pika e dytë është lidhur me atë se sa OJQ Mjalti dhe OJQ tjera janë të përfshira në planifikimet buxhetore. Pika e tretë, sa Komuna parashih në të ardhmen për me i subvencionu fermerët për dëmtimet që pësojnë nga të reshurat, bletarët nga sulmet e ariut siç ka ndodh edhe më herët. Pika e katërt, ne si OJQ Mjalti e kemi diskutu, kemi disa fermerë në Rezhancë nuk kanë ambient/objekt ku me i mbajt kosheret, dhe kemi has se në fshatin REzhancë komuna ua ka dhuru gjuetarëve, dhe prej disa kohësh ai kontinjer nuk përdoret, dhe sa do të ishte mundësia që ai kontenjer me iu dhuru fermerit që ka probleme.

Lindita Ballazhi: Për pyetjen në lidhje me uljen e të hyrave vetanake për vitin 2024. Fillimisht, për vitin aktual projeksionet e të hyrave janë 560 mijë €, kurse për vitin e ardhshme kemi parashiku që të jenë 274 mijë €. Ne vitin e kaluar kemi marrë në konsideratë shlyerjen e borxheve të vjetra prandaj është paraparë se do të ketë rritje të të hyrave me inkasimin e të hyrave nga borxhet nga tatimi në pronë, nga taksa për ushtrimin e veprimtarive, pra në këtë vit

aktual kemi synim t'i mbledhim këto borxhe dhe nëse arrihet kjo, atëherë për vitin 2024 nuk do të ketë më borxhe për t'i inkasuar. Kurse sa i përket çështjes së faljes së tatimit në pronë, Qeveria mund të ketë marrë vendim por ne si komunë nuk kemi pranuar asnjë informatë zyrtare lidhur me këtë, se a do të ketë përditësim në sistem apo se si do të vazhdojë.

Mehmet Ballazhi: Te pika rreth ndarjes së subvencioneve, janë diku 113 mijë € të destinuar për subvencione të përgjithshme, ku këtu përfshihen lehonitë, bursat e studentëve, raste urgjente të sëmundjeve, si dhe subvencionet në bujqësi, kulturë, sport dhe OJQ tjera, pra kemi buxhet shumë të kufizim që duhemi me i mbulu sipas kapaciteteve tona të gjitha këto fusha. Kurse për kontenjerët, ndoshta do të ishte ma mirë që me u kërku si OJQ me e pas si pikë referimi për takimi apo për çka do që ju nevojitet, sepse individualisht nuk kemi mundësi me i mbulu nevojat për kontenjerë për me pas takime rreth veprimtarisë tuaj, megjithatë kemi Shtëpinë e Kulturës ku zyret dhe sallat janë në dispozicion me mbajt takime, aktivitetet për të gjithë ata që shprehin interesim. Kurse te pjesa për me i subvencionu fermerët në rast të dëmtimeve nga faktorë të ndryshëm, nuk kemi kategori buxhetore për me i kompenzu e gjithashtu as buxhet, kjo vlen vetëm në nivelin qendror, të cilët bëjnë kompenzimin e dëmeve të fermerëve.

Shefket Lusnjani: Sot përfaqësoj Shoqatën e Pensionerëve, dhe si informatë në Han të Elezit janë 550 pensionerë dhe kisha kërku që në vitin 2024 me u shtu shuma e subvencionimit të Shoqatës tonë, ose me e rrit numrin e pensionerëve që shfrytëzojnë të drejtën e rehabilitimit në Banjë ose në deti, shkak se kemi probleme në për zgjedhjen e tyre.

Mehmet Ballazhi: Vitin e kalum kemi subvencionu 20 pensionerë, edhe sivjet planifikohet subvencionimi i 20 pensionerëve nga shoqata juaj për rehabilitim në Banjë që jemi në proces të realizimit të amrrëveshjes, dhe ne flasim në bazë të buxhetit tonë që po e ripërsëris që e kemi mjaft të kufizim. Një mundësi është që ne si komunë mund të ofrojmë transportin për në Banjë për ata që e financojnë rehabilitimin por skanë mundësi për transport.

Halim Ballazhi: Sa do të ishte mundësia me u rregullu rruga Rezhancë-Tanas, ku do të bëhej lidhja mes fshatrave Rezhancë, Gorancë e Pustenik, biles ne si banorë shprehim gatishmërinë që ne me e kry e Komuna spaku me na largu shpenzimet e naftës.

Mehmet Ballazhi: Bashkëpunimet mes neve si institucion dhe banorëve do të ketë vazhdimisht, dhe në raste të tilla, mund të bëni kërkesë zyrtare tek ne, dhe ne e shqyrtojmë mundësinë se çka mundemi me ndihmu, qoftë si investim kapital, si mallra dhe shërbime apo subvencionim.

Bunjamin Berisha: Sot vij nga fusha e arsimit dhe sportit, dhe sipas draft buxhetit figuron se grandë specifik i arsimit ka për kriter kryesor numrin e nxënësve dhe parashihet që në vitin 2024 do të ketë rritje të grantit specifik të arsimit, nëse ka mundësi një sqarim në lidhje me këtë, si dhe nëse mundet me na informu lidhur me pjesën e subvencionimit për arsim, kulturë e sport për vitin 2023 dhe sa do të jetë për vitin 2024.

Lindita Ballazhi: Granti specifik i arsimit ka kriter kryesor numrin e nxënësve por jo si kriter të vetëm, ku për vitin e ardhshëm kjo ngritje e këtij granti ka ndodhur si pasojë e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të pagave, ku janë rritur pagat, dhe në vitin aktual granti është diku 96 mijë € është më i ulët se vitin e ardhshëm dhe pagat paguhen nga grandë specifik i arsimit. Kurse për pjesën e

subvencioneve në vitin aktual kemi 100 mijë € subvencione totale, kurse në vitin e ardhshëm parashihen të jenë 113 mijë € si total, ku për vitin 2024 të drejtë subvencionimi kanë zyra e kryetarit, drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca, drejtoria e bujqësisë , drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe sektori i arsimit dhe shkencës. Në shtator do të bëjmë planin e ndarjes së subvencioneve ku do të destinohen këto 113 mijë € nëpër të gjitha kategoritë e mësipërme.

Lindita Ballazhi: Ne i kemi shënuar të gjitha kërkesat e juaja dhe të gjitha do të shqyrtohen dhe do të japim maksimumin që së paku disa të ua realizojmë. Çfarëdo kërkesë që keni, jo vetëm nëpër dëgjime, por çdo herë dyert tona janë të hapura në çdo kohë.

Mehmet Ballazhi: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor të dedikuar për OJQ-të dhe Shoqatat.

Mbledhja përfundoi në ora 11:52.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



**Lista e pjesëmarrësve – Takimi i tretë lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin
2024 – takim me OJQ-të dhe Shoqatat e komunës**

Data: 15.08.2023

Ora: 11:00

Vendi: Salla e takimeve – Komuna Hani i Elezit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënshkrimi
1	Muhammed Sinina	OJQ - MJAFTI	044-227-611	<i>Muhammed Sinina</i>
2	Shefket Juska	OJA - QKAPARREVE	044-138-818	<i>Shefket Juska</i>
3	Maksim Basha	OJA - PONZIOMI	045-346-367	<i>Maksim Basha</i>
4	Natyrja Kalisi	DAP	045-213-639	<i>Natyrja Kalisi</i>
5	Maznuda Kacani	DZHE		<i>Maznuda Kacani</i>
6	Sara Basha	QSS KK	045-261-021	<i>Sara Basha</i>
7	BISAR BUSHI	DZHE	044-486-871	<i>Bisar Bushi</i>
8	Amir Demijani	Z.USHP	044-985-966	<i>Amir Demijani</i>
9	Bejnamin Benishi	KM "SHARRI"	044/151-760	<i>Bejnamin Benishi</i>
10	Rabil Sami	KK	046-184-854	<i>Rabil Sami</i>
11	Florim Shkreta	K.K.	044/855 114	<i>Florim Shkreta</i>
12	Flisna Gup	AKARS	044 909 734	<i>Flisna Gup</i>
13	Armet Hala	OSAMS	049-691560	<i>Armet Hala</i>
14	Vjosa Bobazi	DKA	044- 855 114	<i>Vjosa Bobazi</i>
15	SEVIME BAJRAMI	ZIRTARE FINANCIARE	046-956 162	<i>Sevime Bajrami</i>
16	ALBAN LACI	fyntori i D. D. D. D. D. D.	044-868-051	<i>Alban Laci</i>
17	Dauton Kotori			<i>Dauton Kotori</i>
18	Lindita Ballazi	Drejtoare	049/922-400	<i>Lindita Ballazi</i>
19	MEHMET BALLAZI	KRYETAR	044/225-073	<i>Mehmet Ballazi</i>
20	LIRIDONA BALLAZI	shete kab te kryate	044/862-571	<i>Liridona Ballazi</i>
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				